






KANS

KOSOVO • AIR
NAVIGATION
SERVICES

Titulli: P - 04
Versioni: 1.0
Klasifikimi: Brendshëm
Faqe: 1 nga 4

REPUBLIKA E KOSOVES, AGENCIA E SHERBIMEVE SH NAVEGACIONIT AJRORE REPUBLIKA E KOSOVES, AGENCIA ZA VAZDUSNO NAVIGACIJSKE USLUGE REPUBLICAN KOSOVO, AIR NAVIGATION SERVICES AGENCY	
ZEMRE E AKTIVES KANS, KARTORI DRRIVA CHARTED OFFICE	
Viteti Year Po. no. 04	Data Datum Date 17.12.25
Viteti Year Po. no. 1014	FM LIPJAN, RKS

POLTIKA E PRIVATËSISË TË KANS

	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Ilir Dukolli	Petrit Murtezaj	Samir Bllacaku
Datë	17.12.2025	17-12-2025	17.12.2025
Nënshkrimi			



KANS
KOSOVO • AIR
NAVIGATION
• SERVICES

Titulli: P - 04
Versioni: 1.0
Klasifikimi: Brendshëm
Faqe: 2 nga 4

1. LISTA E SHPËRNDARJES

Kopja	Vendndodhja	Forma	Copë
1	Sistemi për Menaxhimin e Dokumentacionit (SMD) i KANS-s	Elektronike	1
2.	Ueb Faqe	Elektronike	1
3.	Menaxherët e Departamenteve	Elektorinike	1
4.	Arkivi i KANS	E shtypur	1



POLITIKA E PRIVATËSISË

Privatësia dhe mbrojtja e të dhënave personale janë prioritet kryesor i Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror (KANS).

KANS përkushtohet të përpunojë të dhënat personale të palëve të jashtme në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe me legjislacionin përkatës evropian mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

Kjo Politikë e mbrojtjes së të dhënave personale është e zbatueshme nëse jeni aplikant për punë, palë kontraktuese, merrni pjesë në një trajnim të organizuar ose vizitoni KANS-in, përdorni ndonjë shërbim, paraqisni kërkesë përmes email-it apo faqës tonë të internetit.

Përpunuesi dhe përgjegjësi i të dhënave personale

Përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale kryhen nga KANS, i cila është përgjegjëse për mbledhjen, përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave personale që mbledhen gjatë zhvillimit të aktiviteteve dhe shërbimeve të ofruara. Personeli i autorizuar i KANS është përgjegjës për menaxhimin e këtyre të dhënave, duke siguruar përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi.

Kategoria e të dhënave që përpunojmë

Në varësi të qëllimeve dhe arsyeve specifike, KANS përpunon të gjitha ose disa nga të dhënat personale të specifikuar më poshtë, ndaras ose në kombinim midis tyre:

- Të dhënat e identifikimit: emri, mbiemri, të dhënat e dokumentit të identitetit;
- Të dhënat e kontaktit: adresa, e-mail, numri i telefonit;
- Të dhëna për arsimin, shëndetin, kualifikimin profesional dhe veprimtarinë e punës;
- Të dhëna të tjera të kërkuara sipas ligjeve të veçanta që rregullojnë marrëdhëniet e punës ose marrëdhëniet kontraktuale;
- Informacione të tjera dhe të dhëna personale të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve statusore të KANS për të garantuar sigurinë në ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror;
- Foto dhe video nga konferenca apo ngjarje;

Qëllimi i përdorimit të të dhënave personale

Të dhënat personale mund të përdoren për arsyet si në vijim:

- Zbatimin e detyrimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Zbatimin e urdhërave të organeve kompetente shtetërore;
- Përzgjedhjen e punonjësve, duke përfshirë kryerjen e trajnimeve të specializuara dhe gjuhësore për rekrutimet të reja;
- Lidhjen e kontratave dhe marrëdhënieve para kontraktuale;
- Garantimin e sigurisë së punonjësve, vizitorëve, si dhe infrastrukturës së ndërmarrjes, përmes sistemit të mbikëqyrjes video, sigurisë fizike, kontrollit të qasjes dhe regjistrimit të vizitorëve të jashtëm;
- Sigurimin e funksionimit normal, mirëmbajtjes dhe sigurisë së faqes së internetit dhe sistemeve të informacionit dhe komunikimit të KANS;
- Përpunimin e kërkesave sipas Ligjit NR. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike;
- Promovimin e aktiviteteve të KANS, duke përfshirë shpërndarjen e materialeve dhe broshurave reklamuese, postimin e fotove / videove në ueb faqe, Facebook, Instagram, Twitter, LinkedIn ose në media tjera.

Baza ligjore për përpunim

KANS përpunon të dhënat personale të subjekteve në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe në pajtim me legjislacionin evropian për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në disa raste, të dhënat personale përpunohen vetëm pas pëlqimit paraprak të subjektit të të dhënave. Pëlqimi i dhënë mund të tërhiqet në çdo kohë nga ana e subjektit.

Ndarja e të dhënave personale me palë të treta

KANS ka të drejtë të ndajë të dhënat personale me autoritetet kompetente të sigurisë, drejtësisë dhe autoritetet e tjera vetëm kur një akt juridik e detyron ose lejon një veprim të tillë.

Të drejtat e subjekteve të të dhënave personale

Kur të dhënat tuaja personale përpunohen nga KANS, ju keni të drejtë:

- të qasjes në të dhënat tuaja dhe në çdo kohë dhe të kërkonti t'i korrigjoni dhe përditësoni pa vonesë nëse të dhënat tuaja janë të pasakta ose jo të plota;
- të fshirjes së të dhënave tuaja (e drejta për t'u harruar) dhe të kërkonti që përpunimi të ndalohet në rrethana të caktuara;
- të kërkonti që ndonjë nga ndryshimet e mësipërme t'u komunikohet palëve të tjera, të cilave u janë zbuluar të dhënat tuaja;
- të merrni të dhënat tuaja personale në rast se dëshironi t'i transferoni ato në një kontrollues tjetër (transferimi i të dhënave);

E drejta e ankimit

Në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo person fizik që beson se i është shkelur e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të paraqesë ankesë pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi me adresë: Rr. Zejnel Salihu - Nr.22, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Siguria e të dhënave personale

KANS zbaton masat adekuate organizative, teknike dhe fizike për të mbrojtur të dhënat tuaja personale në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave personale varet nga qëllimet e përpunimit për të cilat ato janë mbledhur dhe është e rregulluar me Ligjin përkatës për Arkivat Shtetërore.

Përditësimi i Politikës së Privatësisë

KANS mund ta përditësojë këtë Politikë të Privatësisë sa herë që është e nevojshme dhe çdo ndryshim do të publikohet në ueb faqe, duke u konsideruar i vlefshëm nga momenti i publikimit.

Ueb faqja e KANS mund të përmbajë linqe të ndryshme të faqeve të tjera të internetit, për të cilat rekomandohet leximi i politikave të privatësisë të faqeve përkatëse.